

STATUTI

AKT THEMELIMI I SHOQERISE "Top Tools" SHPK

KREU I

Themelimi, Emri , Objekti , Kohezgjatja , Selia dhe Adresa

Neni I

Baza Ligjore

Sot me dt.**19/01/2023** une, ortaku themelues, kam vendosur hartimin e statutit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin **Top Tools** ne respekte te detyrimeve qe burojne nga **Ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 " Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare "** dhe **ligjit Nr.7923 dt.03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit "**.

Ne kete Statut

"Ligji" eshte **Ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 " Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare"** **"Statuti "** eshte **statuti i shoqerise**

"Dite te Plota" ne lidhje me periudhen e nje njoftimi eshte periudha qe nuk perfshin ditën kur eshte dhene ose kur konsiderohet se eshte dhene njoftimi dhe ditën per te cilen eshte dhene ose hyn ne fuqi njoftimi . .

Ortaket themelues te shoqerise jane :

Admirim Rapi KERRI i datelindjes 24/05/1974 lindur ne Fier dhe banues ne Lagjen "Bishanak" Fier me shtetesi Shqiptare dhe **Redian Rapi KERRI i datelindjes 16/07/1977** lindur ne Fier dhe banues ne Lagjen "Bishanak" Fier me shtetesi Shqiptare, madhor me zotesite plote juridike per te vepruar .



Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryej aktivitetin e meposhtem :

Tregtim materiale hidraulike. Import - eksport, tregtimi me shumice dhe pakice te mallrave hidraulike. Bojra, materiale ndertimi, elektrike, si dhe import - eksport te mallrave te ndryshem tregtimi i lendeve te para per industrine, hidrosanitare, pajisje.

Neni 3

Kohezgjatje Shoqeria krijohet per te ushtuar veprimtarine e saj per nje afate te pacaktuar.

Neni 4

Selia e shoqerise dhe adresa elektronike e saj

Selia e Shoqerise me Pergjeglesi te Kufizuar "Top Tools" do te jete ne **Lagja Bishanake, rruga Skenderbej, Zona kadastrale 85/32 nr pasurise 1/1267.**

Adresa Elektronike e Shoqerise eshte:

toptools2022@yahoo.com

KREU II

Kapitali i rregjistruar

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitali te rregjistruar Kapitali themeltar i rregjistruar i shoqerise eshte 100,000 (njqindmije) leke . Kapitali themeltar prej 100,000 leke perbehet 100 % nga kontributi ne leke qe do te derdhet nga ortaket themelues **Admirim Rapi KERRI dhe Redian Rrapi KERRI**. Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhteme .

Ortaku Admirim Kerri eshte zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50.000 lek(pesedhjet mije) leke qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise dhe do te ngurtesohet ne Banke mbasi Shoqeria te regjistrohet ne

QKB dhe ortakut Redian Kerri është zorerues i 1 (nje) kuote që përben 50 % të kapitalit themeltar me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesëdhjet mijë)leke dhe do ngurtesohet në Banke mbasi Shoqëria të regjistrohet në QKB

Neni 6

Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja kuotave të papaguara

Administratori mund t'u kërkojë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre.

Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaj një interes mbi shumën e papagur me një kamatvonesë prej 4 % në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën .

Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar Administratori mund të njoftojë paraprakisht të paktën katërmbëdhjetë ditë të plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributit, duke i kërkuar pagesën e kontributit të pashlyer dhe të kamatvonesës së llogaritur .

Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, mund të anulohet me vendim të administratorit dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendet ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluarat dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afatëve dhe menyrave që Administratori e konsideron të përshtatshme, Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet çilesinë e ortakut në lidhje me këto kuota por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyeshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës .

Neni 7

Llojet e Kuotave , të Drejtave dhe Kufizimeve



Ne perputhje me dispozitat e Ligjit **Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregetare"** dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese , kuotat mund te emetohen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme , te marre me shumicen e kualifikuar (tre te katertat) te votave te ortakeve , ne perputhje me parashikimet e **Nenit 87 te ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 .**

Neni 8

Certifikata e kuotove

Secili ortak ka te drejte te perfitoje nje certifikate per kuoten e zoteruar prej tij . Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotat e zoteruara bashkarisht .Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne certifikaten e kuotes,certifikata nuk do te zoteroje cilesine e letres me vlere .

Neni 9


Kulimi me Kontrate i Kuotave

Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga Administratoret. Kjo kontrate do dergohet ne seline e shoqerise. Administratoret mund te refuzojne rregjistrimin e kalimit te kuotes ne QKR ne rast se kjo kuote nuk eshte shlyer plotesisht ose ne rast se administratoret nuk jane dakort me personin te cilit i kalon kuota. Nese Administratoret refuzojne kalimin e kuotes , ata do te njoftojne per mospranimin personin te cilit i kalon kuota, brenda nje muaji nga data ne te cilen eshte paraqitur ne shoqeri kerkesa per rregjistrimin e kalimit te kuotes .

Neni 10

Kalimi i koutove me Trashegimi ose si pasoje e Falimentimit

Nese nje ortak vdes, trashegimtari ose trashegimtaret ne rastin e bashkezoterimit te te kuotave dhe trashegimtaret e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem i bashkezoteruesve te kuotave , do te jen personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues se te drejtave mbi kuoten e tij .Pavaresisht parashikimeve te ketij statuti pasuria e ortakut te vdekur nuk clirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me personat e tjere . Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit



te nje ortaku , pas paraqides te provave te kerkuara nga Administratoret, mund te zgjedh te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje rregjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjeter te caktuar prej tij si perfitues te kuotes . Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes ai njofton shoqerine ne le lidhje me kete zgjidhje . Nese ky person zgjedh qe nje person tjeter te rregjistrohet si zoterues i kuotes , ai kalon kuoten ne dobi te personit tjeter. Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes apo falimentimit te nje ortaku do te kete te drejtat qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesmarrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme , deri ne momentin e rregjistrimit ne QKR.

Neni 11

Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltor

Asambleja e pergjithshme me shumice te kualifikuar , mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates .

Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri , miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve .

Shoqeria mund te vendos zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar te votave .

Neni 12

Blerja e kuotave te veta

Shoqeria mund te bleje kuotat e veta dhe te kryeje pagesa per blerjen e tyre , jo nga fitimet e shoqerise qe do t'u shperndahen ortakeve apo emetimi I kuotave te reja vetem nese shoqeria permbush kushtet per shperndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te ligjit dhe Administratoret leshojne nje certificate te aftesis se paguese te parashikuar nga ky nen .

Ne rast se blerja e kuotave te veta nuk eshte ne perputhje me kushtet e nenit 77 te ligjit , padite mbi pergjegjesine e shoqerise mund te ngrihen ne pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 te ligjit .



KREU III

Asambleja e Pergjithshme

Neni 13

Thirrja e Asamblese se pergjithshme

Administratoret therasin Asamblene e Pergjithshme dhe me kerksen e ortakeve sipas nenit 84 te ligjit , do te procedojne me thirrjen e Asamblese Pergjithshme . Mbledhje e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me psote ose poste elektronike drejtuar cdo ortaku , perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket .

Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 dite te plota perpara dates se caktuar per mbledhjen pervec rasteve kur njoftimi i mbledhjes se Asamblese Pergjithshme i cili permban nje afat me te shkurter eshte miratuar ne unanimitet nga te gjithë ortaket

Secilit ortak se bashku me njoftimin per mbledhjen , i dergohet edhe numri PIN per te mundesuar pjesmarrjen dhe votimin elektronik ne mbledhje

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme jane te pavlefshme ne rast moskryerje te paqellimshme te njoftimit apo mosmarrjes se njoftimit te mbledhjes nga persona te cilet kane te drejten te marrin kete njoftim , me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte .

Neni 14

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arrtjen e kuorumit te parashikuar nga neni 86 i ligjiit . Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike perfshire telekonferencen (conference call) ,audio ose audio-video , ne perputhje me nenin 88 te ligjit . Ortaket qe marrin pjese me mjete komunikimi elektronike kane te drejte te votojne nepermjet numrit PIN qe ju eshte derguar se bashku me njoftimin per mbledhjen e asamblese se pergjithshme .



Ne perputhje me te drejttat dhe kufizimet qe rrjedhin nga kuotat , cdo kuote i jep ortakut te pranishem ose perfaqesuesit te tij te autorizuar ose ortakut i cili eshte i pranishem perrnes perfaqesuesit ligjor apo perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt te drejten e nje vote . Asnje ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e asamblese pergjithshme personalisht ose nepermjet perfaqesuesve ne lidtrje me kuoten e zoteruar prej trj , nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote . Cdo kundertshtim ne kohe per cilesin e nje votuesi do ti komunikohet kryetarit , vendimi i te cilit do te jete perfundimtar.

Te gjitha votat e pakundershtuara ne nje mbledhje ose mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme .

Neni 16

Votimi me prokure

Perfaqesuesi do te emerohet nga ortaku sipas formes se zakonshme ose sipas ndonje forme qe mund te miratohet nga Administratori/et . Caktimi me shkrim i perfaqesuesit ose nje kopje e noterizuar apo e miratuar nga Admnistratiri/et depozitohet ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter Brenda teritorit te Republikes se Shqiperise , sic percaktohet ne njoftimin per mbledhjen e Asamblese Pergjithshme ose ne ftesen per te caktuar nje perfaqesues te derguar nga shoqeria ne lidhje me mbledhjen e Asamblese Pergjithshme .

Akti i emerimit te perfaqesuesit duhet te depozitohet jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre net e cilen duhet te votoje perfaqesuesi .

Ne rast se akt i emerimit te perfaqesuesit jepet nepermjet komunikimit elektronik te derguar ne adresen eleketronike sipas percaktimeve te pikes 3 te nenit 4 te ketij statusi , ky akt duhet te merret jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi .

Neni 17

Hetimet e Posacme

Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 91 te ligjit paraqesin nje kerkese te

Administratoret caktojne kryetarin e mbledhjes si edhe nje person per te mbajtur Proces-Verbalin e saj . Administratori,pavaresisht se nuk eshte ortak ka te drejten e pjesmarres si edhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te asamblese se pergjithshme .

Administratori ose Kryetari i mbledhjes , me pelqimin e asamblese se pergjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj , mund te shtyje mbledhjen e asamblese pergjithshme , por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhje e meparshme

Kur mbledhja e asamblese pergjithshme shtyhet te pakten katermbedhjet dite njoftimi do te kryhet te pakten shtate dite te plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites .

Ne rast te kundert dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme . Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte .

Votimi i fshehte mund te kerkohet nga :

I -Kryetari Mbledhjes ose

2-Nje ortake ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5 %te kapitalit themeltar te shoqerise Kerkesa e bere nga nje perfaqesues i autorizuar i ortakut ka te njejten vlere me kerkesen e paraqitur nga vet ortakut . Me perjashtim te kundershtimit te nje ortakut , deklarimi i kryetarit se vendimi eshte marre ne menyre unanime , ose me nje shumice te caktuar nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe rregjistrimi perkates ne Proces-Verbalin e mbledhjes perben prove perfundimtare te ketij fakti, pa pasur nevojte per numurimin e votave te rregjistruara pro ose kunder vendimit . Ne rast se ka kundershtime per kete deklarate do te zhvillohet nje votim i fshehte ne lidhje me percaktimin e numrit te votave dhe kunder vendimit .

Neni 15

Votat e ortakeve



tille nepemjet depozitimit te nje deklarate noteriale ne seline e shoqerise e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi .

KREU IV

Administratori/et

Neni 18

Emerimi i Administratorit/ve

Asambleja e pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizik si administratore te shoqerise per nje periudhe 5 vjecare ne pajtim me parashikimet e shkronjes " c " te pikes I te nenit 81 dhe nenit 95 te ligjit . Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga asambleja e pergjithshme i cili , nese miratohet , sjell emerimin e personit te propozuar si administrator . Kufrizimet ne lidhje me emerimin e Administratoreve parashikohen ne piken 2 te nenit 95 te ligjit. Shoqeria **Top Tools** cakton si administrator te saj **Z. Admirim Kerri**

Administratori Admirim Kerri zgjidhet per nje afat prej 5 vite me te drejte rizgjedhje.

Neni 19

Kompetencat e Administratoreve

Politikat tregtare te shoqerise do te administrohen nga Administratori/et te cilet mund te ushtojne te gjitha kompetencat qe nuk i rezervohen asamblese se pergjithshme sipas nenit 81 te ligjit . Ndryshimet e statusit nga Asambleja e Pergjithshme dhe udhezimet e asamblese se pergjithshme nuk do te shfuqizojne . aktet e meparshme te administratoreve te cilat do te ishin te vlefshme nese ndryshimi nuk do te ishte kryer ose udhezimi nuk do te ishte dhene

Administratoret mun t'ua delegoje kompetencat e tyre cdo komiteti i cili perbehet nga nje ose me shume administratore .

Cdo delegim kompetencash mund te kryhet ne perputhje me kushtet qe mund te vendosin Administratori /et dhe mund te revokohen ose ndryshohen .
Administratori/et Nuk mund te delegojne detyrimet e tyre ligjore .



Neni 20

Skualifikimi dh e Shkarkimi i Administratorit/eve

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se :

1-Personi nuk eshte me Administrator sipas parashikimeve te ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te ligjit .

2-Personi ndodhet ne gjendje paaftesia paguese

3-Personi vuan ose mund te vuaj nga crregullime mendore

4-Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine

5-Personi ka munguar per me shume se 6 muaj radhazi pa lejen e administratoree te tjere ne mbledhjen e administratoreve te mbajtur gjate kesaj periodhe dhe Asambleja e Pergjithshme me propozimin e Administratoreve vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 21

Shperblimi , peffitimet e tjera dhe shpenzimet e administratorit/ve

Administratori/et shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga asambleja e pergjithshme ne perputhje me parashikimet e nenit 97 te ligjit.

Asambleja e Pergjithshme mund te parashikojë perfitime, nepermjet shperblimeve ne para , pensione , sigurime ose forma te tjera per cdo person i cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne shoqeri , shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filajleve te saj , ose per cdo familjar te tyre ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre dhe mund te paguaj kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla .

Administratorit /eve mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit , akomodimit , dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesmarrjen e tyre ne asamblene e administratoreve ose te komiteteve te administratoreve ose te asamblese se pergjithshme ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre .

Neni 22



Proces Verbalet e Mbledhjeve

Administratori/et kujdeset qe ne libra te posacem te mbahen proces verbalet e :

1-Te gjitha takimeve te kryera nga Administratori/et

2-Te gjitha mbledhjeve te Asamblese Pergjithshme

KREU V

Dividentet dhe kalimi i fitimeve ne kapitalin themeltar

Neni 23

Dividendet

Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te ligtrit, shoqeria me shumice te kualifikuar te votive se Asamblese Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve .

Dividendet deklarohen dhe paguhen ne perpjestim te drejte me shumate e paguara per kuotat. Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbart interesa ndaj shoqerise .

Cdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet Brenda dymbedhjet vjeteve nga data e maturimit , ne rast se vendoset me shumice te kualifikuar votash nga Asambleja e pergjithshme, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta paguaj ate .

Neni 24

Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltor

Administratoret , pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash, dhe duke pasur parasysh parimet e perçaktuara ne nenin 14 te ligjit , mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividend preferencial apo shuma te dera te parashikuaraper rezervat e kapitalit te shoqerise .

KREU VI

Prishja dhe njoftimet



Neni 25

Prishja dhe Likujdimi

Ne rast te likujdimit te shoqerise , likujduesi ne perputhje me ligjin dhe me vendimin e marre me shumice te kualifikuar te votave te Asamblese Pergjithshme , mund te shperndaje ne dobi te ortakeve te gjitha ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim , mund te vleresoje cdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shpendarjes midis ortakeve te shoqerise .

Neni 26

Njoftimet

Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te statutit , duhet te jet me shkrim ose nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikuar sipas pikes 3 te nenit 4 te ketij statute dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin .

Shoqeria mund te njoftoje nje ortak personalisht ose duke derguar njoftim me leter porosi me kthim pergjigje ne adresen e rregjistruar te ortakut ose ne adresen apo posten elektronike qe i eshte njoftuar shoqerise nga ortaku .

Ortaket Themelues

Admirim KERRI

Admirim Kërru



Redian KERRI

Redian Kërru

